



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

Komisioni Hetimor “Për kontrollin e ligjshmërisë së veprimeve të kryera nga ana e Presidentit të Republikës së Shqipërisë, në kuadër të ushtrimit të kompetencave të tij lidhur me zhvillimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore.”

Nr. _____ Prot.

Tiranë më 3.12.2019

Drejtuar: Z. GRAMOZ RUÇI
KRYETAR I KUVENDIT

Lënda: *Kërkesë për zgjatje të afatit të veprimtarisë së komisionit të hetimor*

I nderuar zoti RUÇI,

Kuvendi i Shqipërisë me vendimin Nr.84/2019 vendosi ngritjen e Komisionit Hetimor të Kuvendit për shqyrtimin e kërkesës së një grupi deputetësh, për të kontrolluar ligjshmërinë e veprimeve të kryera nga ana e Presidentit të Republikës së Shqipërisë, në kuadër të ushtrimit të kompetencave të tij lidhur me zhvillimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore.

Kuvendi me vendimin nr.112/2019, ka miratuar zgjatjen e afatit të veprimtarisë së Komisionit Hetimor deri më 8.12.2019, afat i cili i shërbeu Komisionit për administrimin e dokumentacionit të ardhur nga institucionet si dhe pritjen e opinionit zyrtar të Komisionit të Venecias.

Komisioni është në fazën e shqyrtimit të këtij dokumentacioni si dhe të opinionit zyrtar të Komisionit Venecias dhe përgatitjen e projekt-raportit e me pas të raportit të Komisionit i cili do t'i dërgohet seancës plenare.

Bazuar në ligjin nr.8891, datë 02.05.2002 “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit”, në nenin 23 të Rregullores së Brendshme për organizimin dhe funksionimin e veprimtarisë së Komisionit Hetimor, në Rregulloren e Kuvendit si dhe për të përmbushur realizimin e veprimtarisë së Komisionit, është e domosdoshme zgjatja e afatit të veprimtarisë së tij.

Në këto rrethana, Komisioni Hetimor, me vendimin e ndërmjetëm nr. 9, datë 3.12.2019, vendosi t’Ju drejtohet me një kërkesë për zgjatjen me 4 muaj të afatit të veprimtarisë së komisionit hetimor.

Me konsideratë,

ZËVËNDËSKRYETAR

Alban ZENELI



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI**

Komisioni Hetimor “Për kontrollin e ligjshmërisë së veprimeve të kryera nga ana e Presidentit të Republikës së Shqipërisë, në kuadër të ushtrimit të kompetencave të tij lidhur me zhvillimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore.”

VENDIM I NDËRMJETËM

Nr. 9, datë 03.12.2019

“PËR ZGJATJEN E AFATIT TË VEPRIMTARISË SË KOMISIONIT HETIMOR”

Komisioni hetimor “Për kontrollin e ligjshmërisë së veprimeve të kryera nga ana e Presidentit të Republikës së Shqipërisë, në kuadër të ushtrimit të kompetencave të tij lidhur me zhvillimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore”, në mbledhjen e tij të datës 18.09.2019, bazuar në nenin 13, pika 2, në nenin 14, shkronja “ç”, të ligjit nr. 8891, datë 2.5.2002, “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit” dhe nenit 7, pika 1, nenit 25 të Rregullores së Kuvendit,

VENDOSI:

- I. T’i drejtohet Kryetarit të Kuvendit, Z.Gramoz Ruçi me një kërkesë për zgjatjen me 4 muaj të afatit të veprimtarisë së komisionit hetimor të Kuvendit “Për kontrollin e ligjshmërisë së veprimeve të kryera nga ana e Presidentit të Republikës së Shqipërisë, në kuadër të ushtrimit të kompetencave të tij lidhur me zhvillimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore”.
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYETARI

ALBAN ZENELI